Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
***Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice***
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korektivna Služba Kosova/Kosovo Correctional Service
*Drejtoria Përgjithshme*

# SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

## Raport vjetor i punës



*2024*

Përmbajtja

Fjala hyrëse nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues

I. PJESA E PARË
Përmbledhje Ekzekutive ....................5-6

II. PJESA E DYTË
Vështrimi i Përgjithshëm- Transparenca ....................7

III. PJESA E TRETË
Çështjet Ligjore....................8-12

IV. PJESA E KATËRT
Qendra Operative- Siguria....................13-25

V. PJESA E PESTË
Trajtimi i të Burgosurve ....................26-31

VI. PJESA E GJASHTË
Financat ....................32

VII. PJESA E SHTATË
Prokurimi ....................33

VIII. PJESAE TETË
Burimet Njerëzore ....................34-36

IX. PJESA E NËNTË
Inxhineringu ....................37

X. PJESA E DHJETË
Teknologji Informative ....................38

XI. PJESA E NJËMBËDHJETË
Njësia për Vlerësim dhe klasifikim të Burgosurve dhe Njësia për Inteligjencë....................39-40

XII. PJESA E DYMBËDHJETË
Njësia Ekonomike ....................41-44

XIII. PJESA E TREMBËDHJETË
Ngjarje të rëndësishme ....................45-51

XIV. PJESA E KATËRBËDHJETË
Përvjetori i 25 i Themelimit të Shërbimit Korrektues ....................52

XV. PJESA E PESËMBËDHJETË
Konferenca Ndërkombëtare e Burgjeve- Singapor ....................53

XVI. PJESA E GJASHTBËDHJETË
Vizita me rëndësi të veçantë ....................54-55

XVII. PJESA E SHTATËMBËDHJETË
Donacione nga partner Strategjik ....................56-58

XVIII. PJESA E TETËMBËDHJETË
Anëtarësimi në EuroPris .................... 59

XIX. PJESA E NËNTËMBËDHJETË
Takim me ndihmës sekretarin Amerikan.................... 60

XX. PJESA E NJËZETË
Promovimi i Librit e mbyllur në vetmi ....................61

**Lista e Shkurtesave**

SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës

IK – Institucionet Korrektuese

QK - Qendra Korrektuese

QP - Qendra e Paraburgimit

BSL - Burgu i Sigurisë së Lartë

QKFL - Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan

QKML - Qendra Korrektuese për të mitur në Lipjan

QEKL - Qendra Edukuese Korrektuese Lipjan

NJPB - Nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve

MPPB - Menaxhimi i parave private të burgosurve

NJVKB - Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve

QAP - Qendra për Aftësim Profesional

APRK - Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

NJIK – Njësia e Inteligjencës Korrektuese

# I. PJESA E PARË

## FJALA HYRËSE NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM I SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS



**Ismail Dibrani**

*Kam nderin dhe kënaqësinë, që në kuadër të transparencës me publikun, të paraqes raportin vjetor të punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës për vitin 2024.*

*Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi aktivitetet dhe veprimtaritë e punës një (1) vjeçare të Shërbimit Korrektues të Kosovës.*

*Të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë angazhimin tonë maksimal në përmbushjen e detyrimeve si dhe identifikimin e fushave të caktuara ku nevojitet rritja e kapaciteteve tona me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve të SHKK-së.*

*Gjatë vitit 2024 SHKK ka qenë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përmes trajnimeve të ndryshme profesionale, vizitave studimore, seminareve, punëtorive etj. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore këtë periudhë SHKK-ja ka rekrutuar 114 zyrtar korrektuese dhe është në proces të rekrutimit edhe për 80 zyrtarë korrektues.*

*SHKK përmes aktiviteteve dhe programeve të ndryshme, krahas mbrojtjes së të drejtave të burgosurve, ka dhënë kontribut në rehabilitimin dhe risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin për ri integrim të suksesshëm në shoqëri.*

*Falënderoj stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës për punën e pa lodhshme në vazhdimësi për përmbushjen e misionit tonë të përbashkët.*

*Falënderoj po ashtu për mbështetjen e pa kursyer Kabinetin e Ministres, Ambasadën Amerikane në Republikën e Kosovës, Misionin e Eulex-it në Kosovë, Misionin e OSBE-së, Këshillin e Evropës, Mediat në Republikën e Kosovës si dhe të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare që në vazhdimësi kanë mbështetur Shërbimin Korrektues të Kosovës.*

*Si SHKK jemi çdo herë të hapur për bashkëpunim me të gjithë duke synuar kështu që të përmbushin plotësisht misionin tonë për risocializim dhe ri integrim të personave të privuar nga liria si dhe duke ofruar siguri për gjithë shoqërinë.*

## Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Punës për vitin 2024 paraqet veprimtarinë e zhvilluar të Shërbimit Korrektues të Kosovës në kuadër të mandatit ligjor, si institucion i pavarur i sigurisë në ushtrimin e funksioneve të veta.

Ky raport përbëhet nga aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2024, të cilat pasqyrojnë të arriturat e Shërbimit Korrektues, me ç 'rast:

- Në pjesën e parë janë paraqitur misioni, vizioni, statusi dhe fushëveprimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- Në pjesën e dytë paraqitet vështrimi i përgjithshëm dhe transparenca.
- Në pjesën e tretë tek çështjet ligjore është paraqitur hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore.
- Në pjesën e katërt janë paraqitur statistika të ndryshme te mbledhura nga Qendra Operative e SHKK-së.
- Në pjesën e pestë janë paraqitë programet dhe aktivitetet për rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve si: programet rehabilituese, arsimimi i të burgosurve, programet trajnuese, punësimi, si dhe aktivitete tjera që kanë të bëjnë me risocializimin e të burgosurve.
- Pjesa e gjashtë pasqyron menaxhimin e parasë publike/buxhetin e SHKK-së, aktivitetet e prokurimit si dhe menaxhimin e parave private të burgosurve.
- Në pjesën e shtatë janë pasqyruar aktivitetet e Prokurimit.
- Në pjesën e tetë janë paraqitur aktivitetet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si: rekrutimi, avancimi i personelit, masat disiplinore si dhe zhvillimi profesional i stafit.
- Pjesa e nëntë paraqet përmirësimin e kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve si dhe projektet e realizuara dhe të monitoruara nga zyra e inxhinieringut.
- Pjesa e dhjetë përfshinë aktivitetet dhe projektet e realizuara në Teknologjinë Informative në SHKK.
- Në pjesën njëmbëdhjetë përfshihet Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve dhe Njësia për Inteligjencë.
- Në pjesën dymbëdhjetë është paraqitur Njësia Ekonomike.
- Në pjesën e trembëdhjetë janë paraqitë ngjarje të rëndësishme.
- Në pjesën e katërmbëdhjetë aktivitete nga përvjetori i 25 i themelimit të Shërbimit Korrektues.
- Në pjesën e pesëmbëdhjetë është paraqitur Konferenca Ndërkombëtare e Burgjeve-Singapor.
- Në pjesën gjashtëmbëdhjetë, vizita me rëndësi të veçantë.
- Në pjesën e shtatëmbëdhjetë, donacionet e pranuara gjatë vitit 2024 nga institucionet dhe OJQ të ndryshme si dhe bashkëpunimet me ta.
- Në pjesën e tetëmbëdhjetë EuroPris.
- Në pjesën e nëntëmbëdhjetë, promovimi i Librit nga e dënuara.

**MISIONI**

Misioni i Shërbimi Korrektues i Kosovës është të siguroj prezencën dhe mirëqenien e personave të privuar nga liria të cilët mbahen në Institucionet Korrektuese, të korrektoj dhe ri socializoj të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fondamentale pa diskriminim si dhe përgatitjen e tyre për jetë në liri si persona të dobishëm për rrethin shoqëror në përgjithësi.

**VIZIONI**

Të promovojë një shoqëri të drejtë dhe të sigurt nëpërmjet menaxhimit efikas dhe efektiv të shkelësve dhe administrimit të drejtësisë.

**STATUSI**

SHKK është Agjenci Ekzekutive e Sigurisë cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka shenjën identifikuese, uniformën, flamurin dhe emblemën.

**FUSHËVEPRIMI SIPAS LIGJIT:**

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të miturve dhe masave edukuese në IK përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe Zbatimin e masës se paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale;
- Ndërmarrjen e masave të sigurisë për të ofruar ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për jetë dhe punë;
- Ndërmarrjen veprimeve për ruajtjen e rendit, disiplinës dhe mbrojtjes së pronës në institucionet korrektuese të SHKK-së;
- Vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për trajtimin e të burgosurve;
- Planifikimin, organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programeve që i kontribuojnë risocializimit të burgosurve;
- Nxitjen, motivimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive punuese për të burgosur;
- Zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njësisë ekonomike të SHKK-së;
- Motivimin dhe krijimin e mundësive për arsimim dhe aftësim profesional për të burgosurit;
- Zhvillimin profesional të personelit të SHKK-së;
- Realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse dhe organizatat të cilat merren me çështjen e monitorimit e të drejtave të burgosurve;
- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar lidhur me planin e ri integrimit pas lirimit;
- Përmbushjen e obligimeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

# II. PJESA E DYTË

## Vështrim i përgjithshëm

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përmbushur obligimet e saj me profesionalizëm dhe integritet, duke u bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligjin për Shërbimin Korrektues të Kosovës aktet nënligjore, rregullat e brendshme, legjislacionin tjetër në fuqi, standardet ndërkombëtare si dhe prioritetet e planit të punës së SHKK-së.

Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë kësaj periudhe, ka arritur të kryej një varg aktivitetesh të fushëveprimit të saj dhe sipas vlerësimit ka shënuar progres në përmbushjen e objektivave të punës si dhe ka qenë transparent për mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive që kemi ndaj të burgosurve, stafit dhe shoqërisë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës me kapacitetet e saj te burimeve njerëzore është angazhuar dhe me përkushtim maksimal profesional për të përmbushur misionin për risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin, duke mbikëqyrur ligjshmërinë e punës për ngritjen e cilësisë të trajtimit, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtat fundamentale të personave të privuar nga liria, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe akomodimit në kuadër të mundësive buxhetore dhe me mbështetje nga donatorët si partner strategjik të SHKK-së.
Drejtori i Përgjithshëm ka përfaqësuar Shërbimin Korrektues të Kosovës në të gjitha proceset brenda dhe jashtë vendit.
Zv. Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme si dhe Institucionet Korrektuese në kuadër të përgjegjësive, kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme për të arritur objektivat e parapara për vitin 2024.

## Transparenca

Në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies, Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) ka vazhduar të përkushtohet në ngritjen e standardeve për informimin publik, forcimin e bashkëpunimit me publikun, si dhe ndërtimin e një komunikimi të qëndrueshëm me mediat elektronike dhe të shkruara. Transparenca, si një prej shtyllave kryesore të punës së SHKK-së, përbën jo vetëm një obligim për të ofruar informacion të saktë, por edhe për të garantuar qasje të lirë dhe të thjeshtë për të gjithë të interesuarit në informacionet që lidhen me punën dhe aktivitetet tona.

Gjatë vitit 2024, Divizioni për Media ka realizuar një sërë aktivitetesh për të përmbushur këtë mision:
**Përgjigje ndaj kërkesave të mediave**: Janë trajtuar dhe përgjigjur gjithsej **90 kërkesa** për informacione nga mediat.
**Qasje në dokumente publike**: Janë pranuar **10 kërkesa për qasje** në dokumente publike, prej të cilave **9 janë miratuar** dhe **1 është refuzuar**, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

- **Storie televizive**: janë realizuar **20 storie televizive** në institucionet korrektuese, duke pasqyruar nga afër punën të arriturat dhe sfidat e këtyre institucioneve.
- **Komunikata për media**: Janë përgatitur dhe publikuar **175 komunikata** zyrtare për media, të cilat janë shpërndarë në mënyrë të rregullt përmes uebfaqes dhe rrjeteve sociale të SHKK-së.
- **Dokumentar për 25-vjetorin e SHKK-së**: Në shënimin e 25-vjetorit të themelimit, SHKK-ja ka përgatitur dhe publikuar një dokumentar që pasqyron historikun, zhvillimin dhe të arriturat e Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- Përmes këtyre aktiviteteve, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka dëshmuar përkushtimin e tij për të qenë institucion transparent, i besueshëm dhe i afërt me publikun dhe mediat. Ne mbetemi të angazhuar për të vazhduar me përmirësimin e komunikimit dhe rritjen e bashkëpunimit me të gjitha palët e interesuara në vitet e ardhshme.

# III. PJESA E TRETË

## Çështjet ligjore

Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes Departamentit ligjor ka siguruar ligjshmërinë e punës së institucioneve korrektuese në mënyrë që çdo aktivitet dhe vendimmarrje te jetë konformë ligjit dhe që shërbimi korrektues gjatë kësaj periudhe ka arrite të përmbush nevojat e rregullimit ligjor të fushëveprimit te saj duke eliminuar vështirësitë dhe zbrastësirat ligjore për një funksionim efikas për të mundësuar realizimin e te drejtave te personave te privuar nga liria te cilët janë në mbajtje në institucione korrektuese.

Në bazë të planit të punës së Departamentit Ligjor i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Planit të punës së Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2024, janë ndërmarr veprime me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe kryerjes së detyrave me përgjegjësi dhe ka arritur që të jap mbështetjen e nevojshme ligjore për funksionimin efikas të SHKK-së dhe në këtë raport vjetor prezantohen të arriturat.

**Obligimet e hartimit të akteve nënligjore** për zbatimin e Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Departamenti ligjor ka planifikuar dhe ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme dhe i ka hartuar projekt udhëzimet administrative për të kompletuar legjislacionin sekondar.

Gjatë vitit 2024 është arritur të miratohen aktet nënligjorë si në vijim:

### Aktet nënligjore të miratuara

Në vitin 2024 janë miratuar projekt aktet nënligjore si në vijim:

- Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të SHKK-së
- Udhëzimi Administrativ për Ushqimin e Personave të Burgosur
- Udhëzimi Administrativ për Procedurën për Punësimin e të Dënuarve, Pezullimin dhe Lirimin e të Dënuarve nga Puna
- Udhëzimi Administrativ për Themelimin, Shuarjen apo Ndryshimin e IK
- Udhëzimi Administrativ për Funksionalizimin e NJPB
- Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen dhe Grumbullimin e Evidencave për Personat ndaj të Cilëve Ekzekutohen Sanksionet Penale
- Udhëzimi Administrativ lidhur me të Dhënat e Personit që Gjendet në Paraburgim
- Udhëzimi Administrativ për Procedurat dhe Kushtet për Gradim të Zyrtarëve Korrektues
- Udhëzimi Administrativ për Kushtet e Punës, duke Përfshirë edhe Kompensimin në rast të Paaftësisë për Punë
- Udhëzimi Administrativ për Procedurën, Klasifikimin dhe Shqiptimin e Dënimeve Disiplinore për Personat e Dënuar

**Rregullat e Brendshme**

- Tretmane për të dënuar.
- Rregull e Brendshme për Pajisjen dhe Përdorimin e Armëve të Zjarrit.
- Praktika standarde për Njësinë e Vlerësimit dhe Klasifikimit për të dënuar.
- Udhëzues për Njësinë për Përcjelljen e të Burgosurve.
- Rregulla për Vlerësimin e Rrezikshmërisë për të Burgosur.

**Vizita në institucionet korrektuese lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit:**

Gjatë vitit janë realizuar vizita në institucionet korrektuese (Qendrën e paraburgimit Mitrovicë, Qendrën Korrektuese Smrekonicë, Burgun e Sigurisë së Lart, Qendrën e paraburgimit Prishtinë, Qendrën Korrektuese për te mitur dhe Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan) lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe janë përcjellë raportet me të gjeturat dhe rekomandimet.

Mbikëqyrja e rregullt dhe rekomandimet për përmirësim kanë ndikuar pozitivisht për të siguruar se veprimet bëhen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit te punës së institucioneve korrektuese, gjithashtu monitorimi është bërë edhe përmes shkresave dhe raporteve të ndryshme të hartuara nga Institucionet Korrektuese.

**Vizita e Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete ne Drejtorin e Përgjithshme**



Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani, ka takuar Anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, me të cilët kanë diskutuar mbi zbatimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, programet rehabilituese, trajtimin dhe kushtet e përgjithshme brenda institucioneve korrektuese.

**Kërkesat për faljen e dënimit:**

Gjithsej gjatë vitit 2024 kemi pranuar dhe përcjell tek organet kompetente 105 kërkesa për faljen e dënimit nga të dënuarit.

Departamenti ligjor ka kontrolluar dhe kompletuar dokumentacionin sipas kërkesave për falje te burgosurve dhe në këtë mënyrë ka siguruar dhe lehtësuar qasjen e te burgosurve për adresimin e kërkesave ne Presidencë për realizimin e te drejtës për Falje. Nuk kemi pranuar as një Dekret për falje nga Presidenca e Republikës së Kosovës

**Kërkesa për pezullim dënimit:**

Gjatë vitit 2024 kemi pasur 11 kërkesa për pezullim dënimit për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore.
4 kërkesa janë aprovuar. Ndërsa për 1 kërkesë është refuzuar nga gjykata.

**Kërkesa për ekstradim dhe transferim:**

Gjatë vitit 2024 në Departamentin ligjore janë pranuar dhe janë përcjellë përgjigje për 9 (nëntë) kërkesa në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë si vijon:

1. Kërkesë për informacion nga zyra Federale Zvicerane lidhur me transferimin e N.K nga BSL në Qendrën Korrektuese në Dubravë (përgjigjeje 11/12/2024}.
2. Një kërkesë për informacion lidhur me transferim të burgosurit L.M nga Institucionet korrektuese të Kosovës në shtetin e Maqedonia e Veriut për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit (Përgjigje me 05.08.2024).
3. Një kërkesë për informacion Nga autoritetet zvicerane lidhur me ekstradimin e të burgosurit P.Gj. në Republikën e Kosovës i kërkuar sipas fletërreshtimit ndërkombëtar nga Gjykata e Gjakovës (Përgjigjeje 08 Qershor 2024).
4. Njoftim Nga autoritetet zvicerane lidhur me lejimin e ekstradimit të Burgosurit I.E. në Institucione korrektuese te Republikës së Kosovës.(01.03.2024)
5. Një kërkesë për informacion nga ambasada norvegjeze për garanci lidhur me kushtet e burgimit dhe trajtimin e të burgosurit në institucione korrektuese në Kosovë (Përgjigje 26.02.2024).
6. Një kërkesë për informacion nga autoritetet Turke lidhur Ekstradimin e të paraburgosurin M.K në institucione korrektuese Turke (Përgjigje 14.02.2024).
7. Një kërkesë për informacion të burgosurit V.K nga Mbretëria e Belgjikës për pjesën e mbetur të dënimit në institucione korrektuese (Përgjigje me 09.02.2024).
8. Një kërkesë për informacion nga autoritetet Austriake(gjyqësore) lidhur me kohëzgjatjen e qëndrimit në burg per te burgosurin V.S. në institucionet korrektuese te republikës së Kosovës (Përgjigje 12.01.2024).
9. Një kërkesë për informacion nga autoritetet e Maqedonis së Veriut lidhur me kohëzgjatjen e mbajtjes në Paraburgim te paraburgosurit L.M në Institucionet korrektuese te Kosovës (Përgjigje 09.01.2024).

**Mbështetja Ligjore**

Brenda vitit 2024 janë dhënë rekomandime dhe opinione ligjore sipas kërkesave të institucioneve korrektuese dhe për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Opinionet kanë qartësuar vendimmarrjen për çështjet të ndryshme dhe kanë siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin ne fuqi .

**Përgjigje në rekomandimet e raporteve të avokatit të popullit**

Gjatë vitit SHKK është monitoruar nga institucione të autorizuara me ligj e posaçërisht nga Avokati i Popullit - kemi pranuara raportet nga Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (Avokati i popullit) për Qendrën Korrektuese për të mitur në Lipjan dhe institucione tjera korrektuese dhe për të gjitha raportet janë kthyer përgjigjet me rekomandime lidhur me ndërmarrjen e masave dhe përmbushjen e tyre duke ngritur në vazhdimësi kushtet e jetesës dhe trajtimit për të burgosur në institucione korrektuese.
Nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti në Institucionet Korrektuese ka qenë në vizitë monitoruese ne QK për te mitur në Lipjan, QK-Dubravë, QP-Prizren.
Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2024 deri me tani ka realizuar 83 vizita të rregullta në Institucionet Korrektuese.
Monitorim kanë bërë edhe Auditorët e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, zyra kombëtare e auditimit, Kryqi Kuq ndërkombëtar si dhe nga mekanizma tjerë hidro sanitar dhe OJQ sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit.

**MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT**

Marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo qeveritare

- Memorandum të Bashkëpunimit ndërmjet së KGJK-në dhe Shërbimin Korrektues i Kosovës
- Marrëveshja për pranimin e donacionit të dhuruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes programit INL.
- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Shërbimin Korrektues i Kosovës dhe Agjencisë së Punësimit.
- Marrëveshja me MD, SHSK dhe SHKK për integrim ne sistemin e MD-se për te burgosurit veprat e te cilëve lidhen me dhunën ne familje.

## Marrëveshjet me organizatat jo qeveritare

Për rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve dhe të miturve janë lidhur këto marrëveshje bashkëpunimi:

- Marrëveshje bashkëpunimi me **OJQ "SIT"** - ri lidhet marrëveshja dy vjeqare për vazhdimin e implementimit të Programit psiko-social "Y+" me të mitur në Q.K.Lipjan dhe Programi" Y+ -shkathtësitë jetësore" për grupin e të burgosurve madhor në Q.K.Dubravë;
- Marrëveshje bashkëpunimi me **OJQ "Monumenta"** me projektin "Art nga Burgu" ku u bë trajnimi i një grupi të të burgosurave gra (10) me aktivitetin "Filigran në letër" i cili u ekspozua në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës; Veprat artistike u shiten në ankand, ndërsa mjetet u depozituan në kontot personale të të burgosurve;
- Marrëveshje bashkëpunimi me **OJQ " Mural Fest Kosova"** me projektin e muraleve për Q.K.Lipjan me angazhim edhe të të burgosurave si për të mësuar teknikat e realizimit të muraleve por edhe duke asistuar në pikturimin e muraleve;
- Marrëveshje bashkëpunimi me **OJQ "Islamic Relief "** për zhvillimin e aftësive profesionale dhe përkrahjen e personave në rehabilitim;
- Memorandum Bashkëpunimi me **Kolegjin Universum** O.P. për ndjekjen e kursit të gjuhës angleze nga ana e të burgosurve me theks të veçantë për të miturit dhe gratë. Nga ky kurs 6-javor u certifikuan 11 të mitur dhe 10 gra të burgosura;
- Marrëveshje bashkëpunimi me "Education+ "që ka për qëllim përmirësimin dhe qasjen në arsim dhe zhvillim profesional për të burgosurit.
- Marrëveshje bashkëpunimi me "La Belle Beauty School Academy Sh.P.K", për mbështetjen dhe fuqizimin e grave të burgosura në Qendrën Korrektuese për Gra në Lipjan me synim për zhvillim profesionale në sferën e floktarisë dhe bukurisë duke ofruar edhe materialet e nevojshme si pajisje dhe produkte.

- Marrëveshje bashkëpunimi me Institutin për Siguri dhe Reziliencë (ISRE) për implementimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe avokuese, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të SHKK-së.

## Sinjalizimi në SHKK

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me qëllim të ngritjes së vetëdijes së personave që mbahen në Institucionet Korrektuese lidhur me përdorimin e mekanizimit të sinjalizimit ka ndërmarr veprimet konkrete për informimin e tyre për shkeljen eventuale të të drejtave dhe beneficioneve që ti adresojnë te zyrtari përgjegjës për sinjalizim dhe njoftimi përpos që është vendos në objektet e Institucioneve Korrektuese i njëjti është shpërndarë secilit të burgosur personalisht me tekstin si në vijim:

**NJOFTIM PËR SINJALIZIM**

**SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

**Të nderuar/a,**

**Si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ju informoj se, pavarësisht kufizimit të lirisë së lëvizjes suaj si pasojë e aktgjykimit dënues që po ekzekutohet ndaj jush, legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e sanksioneve penale ju njeh dhe garanton një varg të drejtash dhe beneficionesh gjatë qëndrimit tuaj në institucionet korrektuese.**

**Me qëllim të sigurimit të drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave tuaja gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale, ju inkurajoj që për çdo shkelje ligjore që ndërlidhet me realizimin e të drejtave dhe beneficioneve tuaja, të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, ta raportoni. Gjithashtu, ju sugjeroj që çdo abuzim apo keqtrajtim që mund të përjetoni gjatë qëndrimit tuaj në institucionet korrektuese, qoftë nga personeli apo të burgosurit, ta raportoni.**

**Ju siguroj se sinjalizimi mund të bëhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale. Për mbrojtjen e të drejtave tuaja, mund të kontaktoni personin përgjegjës për sinjalizim, i cili vepron në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në adresën e poshtëshënuar ose përmes kanaleve të tjera të përcaktuara për sinjalizim.**

**Identiteti juaj do të mbrohet, dhe nuk do të përballeni me pasoja për shkak të raportimit të drejtë dhe të ligjshëm. Çdo raportim nga ana juaj do të trajtohet me seriozitet dhe në përputhje me ligjin nga zyrtari përgjegjës.**

**Duke ju uruar një proces të suksesshëm riedukimi dhe socializimi, ju falënderoj për vëmendjen!**

**Nëse keni nevojë për informacion shtesë mbi procesin e sinjalizimit, ju lutem drejtohuni te zyrtari përgjegjës në numrin dhe adresën e kontaktit si më poshtë:**

**Valon Gashi,**
**Zyrtar Përgjegjës për Sinjalizim**
**Numra të kontaktit:**
**Mobil: 044-553-794**
**Tel Lokal: 038-200-67632**
**Adresa elektronike: valon.i.gashi@rks-gov.net**

**Me respekt,**
**Ismail Dibrani,**
**Drejtor i Përgjithshëm**
**Shërbimi Korrektues i Kosovës**

2024

# IV. PJESA E KATËRT

## Qendra Operative- Siguria

### Pranimet e të burgosurve në institucionet korrektuese

Në Institucionet Korrektuese gjatë periudhës 01.01.2024 deri me 31.12.2024 janë pranuar gjithsejtë **3710** të burgosur.

Prej tyre **1335** të Dënuar meshkuj(madhorë), **26** të Dënuara (Femër), **2156** të Paraburgosur meshkuj(madhorë), **68** të Paraburgosura (Femra), **101** të Mitur të Paraburgosur, **02** e Paraburgosur e Mitur (Femër), **04** të Mitur të Dënuar, **18** të Mitur me Masë Edukative.

***Diagrami i përgjithshëm i të burgosurve të pranuar në Institucionet korrektuese***



** Diagrami i pranimeve të të burgosurve në Institucione Korrektuese- Vitit 2024*

**Lirimet e të burgosurve:**

Sipas raportimeve nga Institucionet Korrektuese gjatë vitit **2024** janë liruar gjithsejtë **3630** të burgosur.

Prej tyre kanë qenë: **1586** të dënuar meshkuj (madhorë), **29** të dënuara madhore (femra), **26** të mitur me masë edukative dhe **1839** të paraburgosur meshkuj (madhorë), **62** të paraburgosura madhore (Femra) dhe **81** të paraburgosur (të mitur), **06** të dënuar (të mitur), **01** e mitur me Masë Edukative (femër)

***Diagrami i përgjithshëm i te burgosurve te liruar nga Institucionet korrektuese***




** Diagrami i lirimeve të të burgosurve nga Institucionet Korrektuese – Viti 2024*

| *Lirimet me kusht* | *Lirimet e parakohshme* |
| --- | --- |

| | |
|---|---|
| -336- | -192- |

**Pushimet e të dënuarve jashtë institucioneve korrektuese:**

Gjithsejtë : **1396** pushime të rregullta të Burgosurve sipas Institucioneve Korrektuese

| QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QP Prishtinë | QK Lipjan | QP Mitrovicë | QP Gjilan | QP Prizren | QP Pejë | QEK Lipjan | QKF Lipjan |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 410 | 123 | 500 | 44 | 63 | 12 | 08 | 47 | 09 | 173 | 07 |

Gjithsejtë : **38** pushime të jashtëzakonshme të Burgosurve sipas Institucioneve Korrektuese

| QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QK Lipjan | QP Pejë | QP Prizren |
|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 01 | 22 | 02 | 01 | 02 |

| Pushime të rregullta | Pushime të jashtëzakonshme |
|---|---|
| -1396- | -38- |

| Totali i të burgosurve qe kanë shfrytëzuar pushimin për vitin 2024 |
|---|
| -465- |

Transferimi i të burgosurve nga një institucion ne institucionet tjera korrektuese të SHKK-së:

Gjatë vitit 2024 janë realizuar **1253** transferime të burgosurve ndër Institucionet Korrektuese, të cilat në përgjithësi janë bërë për shkak të: mbarimit të periudhës së vlerësimit, trajtimit mjekësorë apo në interes të ruajtjes së rendit dhe sigurisë brenda institucioneve korrektuese.

| Muaji | QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QK Lipjan | QP Prishtinë | QP Gjilan | QP Prizren | QP Pejë | QP Mitrovicë | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 03 | 11 | 00 | 00 | 55 | 08 | 08 | 04 | 04 | 93 |
| Shkurt | 32 | 22 | 00 | 01 | 87 | 05 | 01 | 03 | 00 | 151 |
| Mars | 23 | 02 | 01 | 00 | 71 | 11 | 03 | 07 | 00 | 118 |
| Prill | 17 | 02 | 01 | 00 | 37 | 03 | 01 | 01 | 00 | 62 |
| Maj | 24 | 04 | 04 | 01 | 72 | 10 | 07 | 13 | 04 | 139 |
| Qershor | 16 | 03 | 03 | 01 | 30 | 19 | 03 | 07 | 00 | 82 |
| Korrik | 14 | 06 | 05 | 04 | 52 | 25 | 05 | 06 | 03 | 120 |
| Gusht | 21 | 02 | 02 | 02 | 61 | 27 | 03 | 09 | 03 | 130 |
| Shtator | 07 | 01 | 01 | 01 | 47 | 09 | 07 | 05 | 01 | 79 |
| Tetor | 11 | 05 | 02 | 00 | 67 | 21 | 04 | 07 | 01 | 118 |
| Nëntor | 05 | 03 | 00 | 00 | 68 | 17 | 05 | 03 | 00 | 101 |
| Dhjetor | 03 | 01 | 00 | 00 | 38 | 11 | 03 | 02 | 02 | 60 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Totali | 176 | 62 | 19 | 10 | 685 | 166 | 50 | 67 | 18 | 1253 |

## Kontrabanda

| *INSTITUCIONI* | *Telefon* | *Bateri tel/ pjes e tel.* | *Adapter/ose kabllo* | *Sim kartelë* | *Narkotik* | *Bizë* | *Usb-sd* | *Kuffje* | *Thikë e improvizuar* | *Medikamente/ copa* | *Mjetë për tatuazh* | *Parfum ( Copa )* | *Brisk* | *Ngjyre për flok* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***QK Dubravë*** | *15* | *06* | *42* | *06* | *27* | *25* | *03* | *16* | *03* | *03* | *03* | | | |
| ***BSL*** | *01* | | *04* | *05* | *01* | *02* | | | | *02* | *02* | *01* | | *01* |
| ***QK Smrekonicë*** | *02* | | *01* | *01* | | *01* | | | | | | | | |
| ***QK Lipjan*** | *02* | | | *02* | *02* | *02* | *02* | | | | *03* | | | |
| ***QEK Lipjan*** | *01* | | *01* | | *01* | | | | | *01* | | | | |
| ***QP Prishtinë*** | *02* | | *04* | *04* | *06* | *01* | *07* | *01* | | | | | | |
| ***QP Prizren*** | *01* | | *02* | *01* | *01* | | | | | | | | *01* | |
| ***QP Pejë*** | *01* | | *02* | | | | | | | | | | | |
| ***QP Gjilan*** | *02* | | *01* | | *04* | | | *01* | | | | | | |
| ***QKF Lipjan*** | *01* | | | *01* | | | | | | | | | | |
| ***QP Mitrovicë*** | | | | | | | | | | | | | | |
| ***Totali ----->*** | *28* | *06* | *57* | *20* | *42 Raste (90.1 gr)* | *31* | *12* | *18* | *3* | *06 raste ( 15 copa)* | *08* | *01* | *01* | *01* |

**Tabela e përgjithshme e kontrabandës së gjetur në Institucionet Korrektuese Sasia e kontrabandës së gjetur**

**Statistika e gjetjeve dhe parandalimit të kontrabandës në Institucionet Korrektuese**

Gjatë vitit **2024** në Institucionet Korrektuese janë evidentuar **211** bastisje prej të cilave **84 ( 39.81% )** kanë qenë **gjetje** e kontrabandës dhe **127 ( 60.19% )** tjetër kanë qenë bastisje **parandaluese**.

| QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QK Lipjan | QEK Lipjan | QP Prishtinë | QP Prizren | QP Pejë | QP Gjilan | QP Mitrovicë | QKF Lipjan | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **43** | **09** | **03** | **08** | **01** | **05** | **03** | **02** | **02** | **05** | **03** | **84** |

***Bastisjet (gjetje) sipas institucioneve për Vitin 2024***

| QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QK Lipjan | QP Prishtinë | QP Prizren | QP Pejë | QP Gjilan | QP Mitrovicë | QKF Lipjan | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 78 | 08 | 07 | 04 | 16 | 03 | 02 | 04 | 03 | 02 | 127 |

*Tabela e gjetjes së kontrabandës (në sasi) në Institucione Korrektuese gjatë Vitit 2024*



| INSTITUCIONI | Telefon | Adapter/ | Sim kartelë | Narkotik | Usb-sd | Monedha | Medikament | Parfum | brisk |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| QK Dubravë | 48 | 07 | 09 | 21 | 13 | 50 frang+890 euro | 04 | 01 | |
| BSL | 04 | 02 | 04 | 01 | 02 | 10 euro | | | |
| QK Smrekonicë | 04 | 03 | | 04 | | | | 03 | |
| QK Lipjan | 01 | | | 02 | | | | | |
| QEK Lipjan | 02 | | | | | | | | |
| QP Prishtinë | 03 | | | 05 | 04 | 6950 euro | | | 01 |
| QP Prizren | 02 | | 01 | | | | | | |
| QP Pejë | | | | | 03 | | | | |
| QP Gjilan | | | | 03 | | | | | |
| QKF Lipjan | | | | | | 7000 euro | | | |
| QP Mitrovicë | 04 | 02 | | | | | | | |
| Totali | 68 | 14 | 14 | 36 raste (509 gr) | 22 | 08 raste ( 14850 e+50fr.) | 04 Raste (35 copa) | 04 | 01 |

*Diagrami i gjetjes së kontrabandës (në sasi) në Institucione Korrektuese gjatë Vitit 2024*

## Incidentet e raportuara nga Institucionet Korrektuese në numra

| INSTITUCIONI | KRAHJE | SULM NDAJ STAFIT | KËRCNIM NDAJ STAFIT | SULM NDAJ TË BURGOSURVE | VETËLENDIM | TENTIM VARJE | VETË LËNDIM AKSIDENTAL | KËRCNIM NDAJ TË BURGOSURIT | DEMOLIM | ZJARRVËNIE | FJALOSJE | TENTIM IKJE | ARRATISJE NGA QKUK | MOSKTHIM NGA VIKENDI | LARGIM | VETËVARJE | VDEKJE NË BURGJE | VDEKJE NË SPITALE | VDEKJE NË QKMF | DEMONSTRIM MBI ÇATI | REFUZIM MBYLLJE | REFUZIM URDHËRI | AKSIDENT TRAFIKU | NGJITJE MBI ÇATI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| QK DUBRAVË | 50 | 05 | 02 | 09 | 38 | 03 | 09 | 01 | 02 | 03 | 01 | | | 01 | 01 | | | 02 | 01 | 01 | 05 | | | 03 |
| BSL | 09 | | 02 | 03 | 09 | 02 | 01 | | 01 | 01 | 01 | | | | | | | | | | | | | |
| QK SMREKONICË | | | | | 03 | | 03 | | | | | | | | 01 | | | | | | | | 01 | |
| QK LIPJAN | 12 | | | 10 | 06 | | 02 | | 03 | | 01 | | | | | | | | | | | | | |
| QEK LIPJAN | | | | | | | | | | | | | | | 01 | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| QP PRISHTINË | 06 | 02 | | 04 | 10 | 01 | 01 | | | 02 | 01 | | 01 | | | 01 | 02 | | | | | | | |
| QP PRIZREN | 08 | | | 02 | 07 | 01 | 01 | 01 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| QP PEJË | 02 | 05 | 01 | 03 | 14 | | 01 | | 05 | 01 | 01 | | | | | | | | | | 05 | 01 | | |
| QP GJILAN | 06 | 01 | 01 | 02 | 09 | 02 | 01 | | | 02 | | 01 | | | | | | 03 | | | | | | |
| QP MITROVICË | 01 | 01 | 01 | | 10 | 01 | 01 | | | 02 | | | | | | | | | | | | | | |
| QKF LIPJAN | 04 | 02 | 01 | 01 | 05 | 03 | 01 | | 02 | | 02 | | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 93 | 16 | 02 | 11 | 111 | 15 | 21 | 01 | 13 | 11 | 07 | 01 | 02 | 01 | 03 | 01 | 02 | 03 | 01 | 01 | 10 | 01 | 01 | 03 |

*Tabela. 7. Incidentet në Institucionet Korrektuese gjatë Vitit 2024*

## Lëvizjet dhe përcjelljet e të burgosurve jashtë Institucioneve Korrektuese për vitin 2024

| Të burgosur | Gjykatë | Prokurori | Spitale | Transfere | Përcjelljet humanitare | Shkollim jashtë IK | Kategori RRL | Kategori RRSHL | Shërbime Sociale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 482 | 157 | 225 | 93 | 10 | 01 | 35 | 14 | 00 | 968 |
| Shkurt | 466 | 144 | 274 | 151 | 22 | 03 | 28 | 03 | 00 | 1060 |
| Mars | 476 | 151 | 316 | 118 | 14 | 00 | 37 | 03 | 00 | 1075 |
| Prill | 469 | 125 | 272 | 62 | 10 | 11 | 33 | 05 | 00 | 949 |
| Maj | 425 | 182 | 293 | 139 | 22 | 19 | 28 | 04 | 13 | 1093 |
| Qershor | 463 | 194 | 286 | 82 | 19 | 09 | 29 | 03 | 14 | 1067 |
| Korrik | 564 | 245 | 326 | 120 | 20 | 03 | 40 | 13 | 00 | 1278 |
| Gusht | 331 | 250 | 328 | 130 | 19 | 01 | 17 | 12 | 00 | 1059 |
| Shtator | 498 | 189 | 349 | 79 | 15 | 00 | 38 | 13 | 00 | 1130 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tetor | 560 | 235 | 346 | 118 | 17 | 00 | 44 | 21 | 00 | 1276 |
| Nëntor | 495 | 181 | 306 | 101 | 18 | 00 | 40 | 15 | 31 | 1132 |
| Dhjetor | 530 | 173 | 317 | 60 | 24 | 00 | 36 | 20 | 16 | 1120 |
| Totali | 5759 | 2226 | 3638 | 1253 | 210 | 47 | 405 | 126 | 74 | 13207 |

*Tabela.9. Lëvizjet dhe përcjelljet e të burgosurve*

***Diagrami i përgjithshëm i lëvizjeve të burgosurve jashtë Institucioneve Korrektuese***




*Diagrami i përcjelljeve të burgosurve nga NJPB - stafi korrektues i IK*

Përcjelljet humanitare të burgosurve - 2024

**Përcjelljet humanitare të të burgosurve**

*Në përcjellje për arsye humanitare gjatë Vitit 2024 janë dërguar **210** të burgosur.*

| QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QK Lipjan | QEK Lipjan | QP Mitrovicë | QP Prishtinë | QP Prizren | QP Gjilan | QP Pejë | QKF Lipjan |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 94 | 30 | 20 | 09 | 03 | 07 | 19 | 06 | 14 | 04 | 04 |

Tabela.10. Përcjelljet humanitare ne vitin 2024

*Gjithashtu edhe 47 të burgosur të mitur kanë shkuar në Shkollë të mesme, Fakultete dhe Kolegje Private nën përcjelljen e stafit dhe prindërve*

| QK Lipjan | QK Lipjan |
|---|---|

| | |
|---|---|
| 36 | 11 |

Tabela.11. Përcjelljet humanitare ne vitin 2024

## Instituti i psikiatrisë forenzike – ipfk

Në **Institutin Psikiatrisë Forenzike (IPFK)** në QKUK aktualisht janë **( 11 )** të burgosur të hospitalizuar për trajtim dhe ekzaminim ( meshkuj ) .Në IPFK gjatë Vitit 2024 janë bërë **74** Trajtime Psikiatrike, **( 32 )** kthime në Institucione Transfere.

**Lëvizjet e të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese** sipas raportimeve në Qendrën Operative – të ndara sipas Institucioneve Korrektuese.

Gjithsejtë 3638 lëvizje të të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese

| | QK Dubravë | BSL | QK Smrekonicë | QK Lipjan | QEK Lipjan | QP Prishtinë | QP Pejë | QP Prizren | QP Gjilan | QP Mitrovicë | QKF Lipjan | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 62 | 23 | 09 | 04 | 00 | 38 | 09 | 15 | 33 | 03 | 29 | 225 |
| Shkurt | 82 | 33 | 03 | 07 | 02 | 62 | 14 | 18 | 33 | 06 | 14 | 274 |
| Mars | 103 | 36 | 22 | 04 | 00 | 56 | 11 | 27 | 35 | 09 | 13 | 316 |
| Prill | 64 | 30 | 14 | 12 | 03 | 55 | 13 | 24 | 40 | 08 | 09 | 272 |
| Maj | 66 | 24 | 28 | 04 | 01 | 39 | 20 | 33 | 51 | 06 | 21 | 293 |
| Qershor | 104 | 15 | 18 | 02 | 01 | 53 | 08 | 15 | 48 | 06 | 16 | 286 |
| Korrik | 105 | 25 | 11 | 09 | 04 | 60 | 09 | 26 | 60 | 05 | 12 | 326 |
| Gusht | 95 | 39 | 04 | 04 | 05 | 38 | 12 | 33 | 77 | 11 | 10 | 328 |
| Shtator | 100 | 35 | 12 | 09 | 02 | 52 | 20 | 22 | 61 | 13 | 23 | 349 |
| Tetor | 118 | 36 | 09 | 13 | 02 | 53 | 08 | 11 | 46 | 17 | 33 | 346 |
| Nëntor | 106 | 27 | 04 | 07 | 02 | 76 | 04 | 24 | 33 | 09 | 14 | 306 |
| Dhjetor | 81 | 23 | 11 | 12 | 02 | 73 | 10 | 25 | 38 | 15 | 27 | 317 |
| Totali | 1086 | 346 | 145 | 87 | 24 | 655 | 138 | 273 | 555 | 108 | 221 | 3638 |

*Tabela. 11. Numri i lëvizjeve të të burgosurve sipas Institucioneve*

*Diagrami i përgjithshëm i lëvizjeve të të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese*




*Diagrami i lëvizjeve të të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese*

## Ekstradimet e të burgosurve

**Gjatë Vitit 2024 nga Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës janë ekstraduar gjithsejtë: 29 të burgosur.**

| Nr | Institucioni | Statusi | Vepra | Data e Ekstradimit | Shtetas | Vendi i Transferit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BSL | I Paraburgosur | Trafikim me narkotik,+ | 07.03.2024 | Shqiptarë | Shqipëri |
| 2 | QP Gjilan | I Paraburgosur | Posedim i narkotikëve | 22.03.2024 | Turk | Turki |
| 3 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Vrasje në tentativë | 25.03.2024 | Shqip-Kos. | Slloveni |
| 4 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Abuzim seksual me fëmijë | 25.03.2024 | Turk | Gjermani |
| 5 | BSL | I Paraburgosur | Vrasje në tentativë | 17.04.2024 | Shqip-Kos. | Norvegji |
| 6 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Grabitje | 26.04.2024 | Turk | Turki |
| 7 | QP Gjilan | I Paraburgosur | Keqpërdorim i detyrës zyrtare | 26.04.2024 | Shqip-Maqedonia. | Maqedonia e Veriut |
| 8 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Grabitje | 17.05.2024 | Shqip-Maqedonia. | Maqedonia e Veriut |
| 9 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Vrasje e rëndë | 18.06.2024 | Shqip-Maqedonia | Maqedonia e Veriut |
| 10 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Narkotik | 27.06.2024 | Shqip-Kos. | Maqedonia e Veriut |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | armë mbajtje pa leje | 11.07.2024 | Shqip-Kos. | Maqedonia e Veriut |
| 12 | QKF Lipjan | E Paraburgosur | Mashtrim | 17.07.2024 | Austrisë | Gjermani |
| 13 | QP Gjilan | I Paraburgosur | Vrasje | 18.07.2024 | Shqip-Maqedonia | Maqedonia e Veriut |
| 14 | QP Gjilan | I Paraburgosur | Sulm dhe posedim i armës | 18.07.2024 | Shqip-Maqedonia | Maqedonia e Veriut |
| 15 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | falsifikim i dokumenteve | 23.08.2024 | Shqip-Kos. | Shqipëri |
| 16 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm | 05.08.2024 | Shqip-Maqedonia | Maqedonia e Veriut |
| 17 | BSL | I Paraburgosur | Pjesëmarrje organizim i grupit kriminal të organizuar | 23.08.2024 | Shqip-Shqiptarë | Shqipëri |
| 18 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Narkotik | 13.09.2024 | Shtetas Malazezë | Slloveni |
| 19 | QKF Lipjan | E Paraburgosur | Trafikim i sasive të vogla Narkotike | 23.10.2024 | Shtetase e Gjermanisë | Gjermani |
| 20 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Vrasje, Grabitje | 06.11.2024 | Shqip-Kos. | Gjermani |
| 21 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Vrasje | 12.11.2024 | Shqip-Kos. | Angli |
| 23 | QK Dubravë | I Paraburgosur | Vrasje e rëndë | 14.11.2024 | | Maqedonia e Veriut |
| 24 | QP Pejë | I Paraburgosur | Vjedhje identitetit, narkotik | 22.11.2024 | Shqip-Shqiptarë | Itali |
| 25 | BSL | I Paraburgosur | Formim i organizates kriminale | 29.11.2024 | Shtetas Malazezë | Mali i Zi |
| 26 | BSL | I Paraburgosur | Legalizim i përmbajtes së rreme | 02.12.2024 | Shqip-Shqiptarë | Shqipëri |
| 27 | BSL | I Paraburgosur | Trafikim me Narkotik | 03.12.2024 | Shtetas Turk | Turki |
| 28 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Rrëmbim, Shantazh | 04.12.2024 | Shtetas Grekë | Greqi |
| 29 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Vrasje e rëndë | 11.12.2024 | Shqip-Kos. | SHBA |

**Ekstradimet gjate vitit 2024 nga Institucionet Korrektuese**

## Ndërsa nga shtetet tjera te ekstraduar ne Republikën e Kosovës janë gjithsejtë -30- të burgosur.

| Nr. | Institucioni | Statusi | Vepra | Dënimi | Data | Shteti nga Ekstradohet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QP Prishtinë | I Dënuar | Narkotik | 4-Vite e 6 muaj | 04.01.2024 | Suedia |
| 2 | QP Prishtinë | I Dënuar | Mashtrim | 1-Vitë | 10.01.2024 | Gjermania |
| 3 | QP Prishtinë | I Dënuar | Kundër sigurisë në trafik | 6-Vite | 17.01.2024 | Kroacia |
| 4 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vjedhje e rëndë | 1-Vite e 6 muaj | 24.01.2024 | Kroacia |
| 5 | QP Prishtinë | I Dënuar | Grabitje | 3-Vite | 26.01.2024 | Gjermania |
| 6 | QP Prishtinë | I Dënuar | Narkotik | 3-Vite | 30.01.2024 | Italia |
| 7 | QP Prishtinë | I Dënuar | Lëndim i lehtë trupor | 120-Ditë | 15.02.2024 | Zvicra |
| 8 | QP Prishtinë | I Dënuar | Narkotik | 1-Vite | 08.03.2024 | Gjermania |
| 9 | QP Prishtinë | I Dënuar | Rrezikim trafiku publik | 13-Muaj | 13.03.2024 | Zvicër |
| 10 | QP Prishtinë | I Dënuar | Ngasje në gjendje të paaftë | 3-Vite | 19.04.2024 | Zvicra |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | QK Lipjan | Me masë Edukative | Grabitje | 1-Vitë | 24.04.2024 | Shqipëri |
| 12 | QP Prishtinë | I Dënuar | Kanosje, Aksident | 3-Vite e 6 muaj | 08.05.2024 | Franca |
| 13 | QP Prishtinë | I Dënuar | Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës Zyrtare | 3-Vite | 10.05.2024 | Gjermania |
| 14 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vrasje në tentativë | 2-Vite e 4 muaj | 01.07.2024 | Franca |
| 15 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vjedhje e rëndë | 08-Muaj | 22.07.2024 | Mali i Zi |
| 16 | QP Prishtinë | I Dënuar | Kanosje | 2-Vite e 20 ditë | 27.07.2024 | Franca |
| 17 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vrasje e kryer në gjendje të tronditur | 3-Vite | 07.08.2024 | Franca |
| 18 | QP Prishtinë | I Paraburgosur | Grabitje | 30-Ditë | 07.08.2024 | Gjermania |
| 19 | QP Prishtinë | I Dënuar | Rrëmbim, | 2-Vite | 08.08.2024 | Gjermania |
| 20 | QP Prishtinë | I Dënuar | Tentim grabitje | 4-Vite e 6 Muaj | 09.08.2024 | Zvicër |
| 21 | QP Prishtinë | I Dënuar | Sulm seksual | 3-Vite | 26.08.2024 | Gjermania |
| 22 | QP Prishtinë | I Dënuar | Kontrabandim me migrant | 3 Vite e 4 muaj | 04.09.2024 | Italia |
| 23 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vjedhje | 8-Muaj | 07.10.2024 | Mali i Zi |
| 24 | QP Prishtinë | I Dënuar | Narkotik | 5-Vite | 02.10.2024 | Maqedonia e Veriut |
| 25 | QP Prishtinë | I Dënuar | Narkotik | 5-Vite | 02.10.2024 | Maqedonia e Veriut |
| 26 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vjedhje e rëndë | 3-Vite | 16.10.2024 | Gjermania |
| 27 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vjedhje e rëndë | 3-Vite | 05.11.2024 | Mali i Zi |
| 28 | QP Prishtinë | I Dënuar | Rrezikim i trafikut publik | 1-Vitë | 05.11.2024 | Mali i Zi |
| 29 | QP Prishtinë | I Dënuar | Vjedhje e rëndë | 1 vitë e 25 ditë | 13.12.2024 | Mali i Zi |
| 30 | QP Prishtinë | I Dënuar | Kanosje & Lëndim i lehtë trupor | 180-Ditë | 16.12.2024 | Franca |

## Lista e të burgosurve të Kategorizuar

| INSTITUCIONI | Totali | Të dënuar | Të paraburgosur | RR.SH.L | RR.L |
|---|---|---|---|---|---|
| BSL | 70 | 26 | 44 | 20 | 50 |
| QK Dubravë | 11 | 10 | 01 | 02 | 09 |
| QP Prishtinë | 3 | 00 | 03 | 01 | 02 |
| QP Gjilan | 05 | 01 | 4 | 3 | 2 |
| QKF Lipjan | 01 | 00 | 01 | 00 | 01 |
| QP Prizren | 02 | 00 | 02 | 02 | 00 |
| TOTAL | 92 | 37 | 55 | 28 | 64 |

**Mos kthimet nga vikendi:**

**Gjatë Vitit 2024 në Institucionet Korrektuese kemi pasur një ( 01 )rast të mos kthim nga Vikendi**

**Largimet nga Institucionet Korrektuese**

1. Me datën 10.01.2024 është larguar i mitur L.K. nga QEK Lipjan, i njëjti me datë 25.02.2024 është arrestua nga Policia dhe është kthye në Institucionin Korrektues për të Mitur në Lipjan.
2. Me datën 05.07.2024 nga QK Smrekonicë është larguar i burgosuri F.H.
3. Me datën 12.07.2024 nga QK Dubravë- Pavioni i hapur është larguar i burgosuri U.M, i njëjti me datën 24.07.2024 është arrestuar nga Policia e Kosovës dhe është sjellë në vuajtje të dënimit në Institucionin Korrektues.
4. Me datën 06.08.2024 i burgosuri L.XH. është arratisur nga QKUK-Klinika e Hematologjisë, i njëjti është arrestuar nga Policia e Kosovës dhe është kthyer në vuajtje të dënimit në Institucionin Korrektues.

**Të burgosur të cilët kanë punuar jashtë Institucioneve Korrektuese**

- Nga data 01.01.2024 deri me datën 31.12.2024 nga QK Smrekonicë **39** dhe nga QK Dubravë **09** të burgosuri kanë punuar jashtë Institucionit Korrektues nëpër Firma të ndryshme në R. e Kosovës.

**Pezullim i dënimit për të burgosurit:**

- Me datën 16.02.2024 të burgosurit N. B. ju ka pezulluar dënimi;
- Me datën 03.04.2024 të burgosurit J. J. ju ka pezulluar dënimi;
- Me datën 05.04.2024 të burgosurit S. V. ju ka pezulluar dënimi;
- Me datën 23.04.2024 të burgosurit L. T. ju ka pezulluar dënimi.
- Të dënuarit S.G i është vazhduar pezullimi i dënimit.

# V. PJESA E PESTË

## Trajtimi i të Burgosurve

### Rehabilitimi/Risocializimi i të burgosurve dhe përgatitja për ri integrim

Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar për ti ndihmuar të burgosurit që të ndryshojnë pozitivisht dhe të përgatiten për ri integrim në shoqëri, si individ të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shoqërinë dhe rrethin ku do të jetojnë.
